



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 5711 Prot.
Datë: 14. 04. 2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 09. 04. 2020

VENDIM
Nr. 25, datë 09. 04. 2020

PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE,
PËR VITIN 2020

Mbështetur në nenin 49, pika 1, shkronja c, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 69, datë 25. 03. 2020 "Për miratimin paraprak të planit buxhetor të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë", aneksin 7A. PBA dhe relacionin e draft-buxhetit të Administratorit të UV-së dërguar me e-mail, si dhe argumentimeve dhe dokumentacioneve të kërkuara nga anëtarët e B.A-së, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 09.04.2020.

VENDOSI

1. Të miratojë buxhetin vjetor të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë, për vitin 2020.
2. Fondi i planifikuar për qeramarrjen e ambjenteve të FSHP, të përdoret në bazë të kërkesave të ardhura nga fakulteti dhe miratuar në Rektorat me Vendimin nr. 7, datë 02.03.2020, si dhe duke marrë parasysh rrethanat e reja të zhvillimit të leksioneve për shkak të situatës emergjente shkaktuar nga infeksioni COVID-19 si dhe periudhën dhe ecurinë e kësaj situatë.
3. Këtij vendimi i bashkëlidhen aneksi 7 A. PBA 2020 dhe relacioni i draftbuxhetit 2020, dërguar me e-mail nga administratorja.
4. Pjesë integrale e këtij buxheti do të jenë dokumentat si më poshtë:
 - Tabela hyrje/të ardhura, sipas shkresës Nr. 511 prot, datë 06.03.2020 "Propozime variante zhvillimi draft-projekt buxheti 2020", të Administratores së Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

- Preventivat e investimeve të planifikuara për vitin 2020.
 - Preventivat e investimeve të prokuruar në vitin 2019.
 - Preventivi i bibliotekës dixhitale sipas vendimit nr .53, datë 26. 11. 2019 të BA.
 - Tabela e ngurtësimeve në thesar për garancinë e objekteve të prokuruar në vite.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Sherbimeve Mbështetëse në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë,
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. ERVIS MOCKA

